



Prishtinë: 29.08.2014

Kodi i ZRRE-së: V_649_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1155_06_14**;
- Ankesa e konsumatorit e datës 30.06.2014.

në seancën e mbajtur më datë 29 gusht 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit E. A. me shifër DPR 90088770 nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1155_06_14 i datës 05.06.2014.

Arsyetim

Me datë 17.09.2013 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për pranimin e instalimit të njehsorit elektrik kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, dhe gjatë inspektimit kanë bërë pranimin teknik të njehsorit elektrik nr. 92624234 me gjendje TL=009538 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=024566 kWh (tarifa e ulët). Pas këtij procesverbali Departamenti i Faturimit në KEDS me datë 05.10.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën shtator 2013 në vlerë financiare **1,840.60 €**.

Me datë 16.10.2013 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kundërshtuar faturën e muajit shtator 2013 për shkak të faturimit të shpenzimit (kWh – kilovatorë) të grumbulluar për periudhën pesë vjeçare.

Departamenti për Konsumator në KEDS me datë 16.12.2013 i është përgjigjur ankesës së konsumatorit duke e refuzuar e tij bazuar në PEE 7173 të datës 30.05.2013 dhe rrjedhës së energjisë elektrike.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEDS-it me datë 27.12.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke kontestuar faturën e muajit shtator 2013. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 05.06.2014 ka nxjerr vendim duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEDS-i që të: i) anulon korrigjimin numër 59288, 59290 dhe 59292DPR-90088770-9008 të datës 14.12.2013 në vlerë **-127.43€**, në shifrën DPR – 90088770; dhe ii) Korrigjon faturën numër 06130DPR-90088770 të datës 05.10.2013 në vlerë **-177.62€** në shifrën DPR – 90088770, duke bërë shpërndarjen e



shpenzimit (kWh) të regjistruar në procesverbalin e pranimit të instalimit elektrik nr. 004593 të datës 17.09.2013 për periudhën 08/2010 deri më 09/2013.

Baza e kundërshtimit të konsumatorit të theksuara në ankesë është se konsumatori ka blerë banesën me datë 09.04.2008 nga kompania Kosova Hawaii Grup dhe se nga ky vit është lëshuar me qera studentëve dhe se për çdo vit ata e kanë pasur obligim të paguajnë rrymën, ujin dhe mbeturinat, por që faturat nuk i kanë shkuar dhe se nuk ka qenë në dijeni për këtë. Konsumatori në ankesë ka theksuar se me datë 17.09.2013 ka lajmëruar inkasantin se banesa që dy muaj është e lirtë dhe se faturat tjera si ajo e ujit dhe e mbeturinave ka ardhur por jo e rrymës, andaj e kemi kontrolluar njehsorin dhe ka theksuar se do të shiqoj këtë çështje. Konsumatori thekson se kompania në fjalë e ka pasur obligim me i regjistru njehsorët elektrik dhe të ma dorëzoj banesën me të gjitha obligimet tjera dhe se KEK-u nuk është se nuk i ka pasur të dhënat e mija pasi që kompania i kishte dërguar të gjitha të dhënat atëherë pse është kyçur njehsori dhe pse nuk është shkyçur për pesë vite. Konsumatori thekson se ka edhe lokale tjera por në ato lokale nuk ka asnjë problem. Konsumatori në fund kërkon që t'i shlyhet ky borxh i energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29 gusht 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, dhe pas vlerësimit të gjitha këtyre shkresave ka vërejtur se DMK, ka vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi me rastin e marrjes së këtij vendimi. Bordi i ZRRE-së ka konstatuar se sipas procesverbalit të pranimit të instalimit elektrik nr. 004593 i datës 17.09.2013 njehsori elektrik i konsumatorit ka qenë i kyçur në rrjetin elektrik edhe para pranimit teknik të instalimit dhe kjo vërehet me gjendjen e pranimit të njehsorit elektrike: TL=009538 kWh dhe TU=024566 kWh. Pas faturimit të KEDS-it me faturën mujore të periudhës 09/2013 prej 34,220 kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 1840.60€, Departamenti i Faturimit në KEDS ka bërë korrigjimin e asaj fature në vlerë prej -127.43€ duke bërë shpërndarjen e shpenzimit prej periudhës 12/2010 e deri më 09/2013.

Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së lëndës së konsumatorit ka vërejtur se KEK nuk ka respektuar Rregullën për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike me rastin e mos regjistrimit të njehsorit elektrik kur edhe është bërë regjistrimi i njehsorëve tjerë në atë objekt, dhe atë në mungesë të informatave personale, por që kjo është në kundërshtim me dispozitat e nenit 5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike mbi obligimet e furnizuesit dhe operatorit të sistemit.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Kontratën - Akt mbarimin të lidhur mes E. A. dhe kompanisë "Kosova Hawaii" grp. nënshkruar dhe vulosur me datë 18.08.2010, si dhe shkresat zyrtare të përgjegjësve të KEK-ut të Divizionit të Rrjetit në Prishtinë me të cilat vërtetohet se kërkesa për legalizimin e këtyre njehsorëve është bërë më herët nga ana e konsumatorëve, dhe nga këto dokumente ka vërejtur se shkresa e parë e KEK-ut e datës 25.08.2010 është shkresa e parë ku është kërkuar që të bëhet regjistrimi i njehsorëve që jetojnë te objektet e ndërtuara nga "Kosova Hawaii" grp. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së thekson se KEDS-i nuk ka vepruar drejt me rastin e shpërndarjes së shpenzimit për periudhën 12/2010 deri më 09/2013, pasi që konsumatorit është dashur t'i bëhet korrigjimi nga periudha gusht 2010 sipas kërkesës së konsumatorëve të evidentuar edhe në shkresat e brendshme të cilat kanë qarkulluar në mes përgjegjësve të KEK-ut dhe ajo shkresë është zyrtare e KEK-ut. Andaj Bordi konstaton se korrigjimi i theksuar në vendimin e DMK prej -177.62€ është vendim i drejtë dhe i bazuar në dokumente zyrtare. Shlyerja e atij borxhi nuk mund të ndodh për arsye se edhe në ankesën e juaj keni theksuar se në atë banesë është krijuar shpenzim i energjisë elektrike dhe se kjo vërtetohet edhe me procesverbalin e pranimit të instalimit të njehsorit elektrik nr. 004593 i datës 17.09.2013, por që nuk janë faturuar me kohë.



Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.08.2014 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1155_06_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar